



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:128195

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05766693

KF.nr.575/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala , dhe zyrtaren ligjore Arta Hyseni në konfliktin tregtar administrativ të paditësit N.T.P “Tafaj & CO” Sh.P.K., me numër fiskal 601736351 me seli në Gelancë, Komunë e Suharekës, përfaqësuar nga Shoqëri e Avokatëve “SCLR Partners” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, baza juridike kundërvajtje doganore, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 13.05.2024 në prani të përfaqësuesit të palës paditëse Avokatit Qëndrim Zogaj nga Shoqëri e Avokatëve “SCLR Partners” Sh.P.K., dhe përfaqësuesit të palës së paditur Xhafer Krasniqi, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.P “Tafaj & CO” Sh.P.K. me seli në Gelancë, Komunë e Suharekës.
- II. ANULOHET Aktvendimi me nr.01.3.2.2/7275-19; 7114-19 të datës 07.05.2021, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit N.T.P “Tafaj & CO” Sh.P.K. , me seli në Gelancë, Komunë e Suharekës, t’ia pranoj deklarimin e kodit tarifor 8438 8010 00 për mallin lëndor sipas DUD-ave R 19013, R 34794 dhe 16485, dhe të ia kthej shumën e paguar në emër të kundërvajtjes së pretenduar doganore në vlerë prej 625.00 € (gjashtëqindën e njëzet e pesë euro).
- IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi N.T.P “Tafaj & CO” Sh.P.K., me seli në Gelancë, Komunë e Suharekës, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 22.06.2021, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/7275-19; 7114-19 të datës 07.05.2021, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadiës si të bazuar. Gjatë seancës së fundit të shqyrtimit kryesor publikë të datës 13.05.2024 përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se ashtu siç e kemi njoftuar gjykatën përmes parashtrësës të datës 29.04.2024 paditësi ka bërë pagesën e gjobës së shqiptuar në aktvendimin 03.1.7-2019-927/2 dhe atë në lartësi prej 50% të gjobës së shqiptuar respektivisht në shumë prej 625.00 euro, këtë ia kemi përcjellë të paditurës me e-mail të datës 07.05.2024 dhe nga e paditura kemi marrë përgjigje me e-mailin e datës 08.05.2024 me të cilën është konfirmuar kjo pagesë. Tutje gjykatës ia dorëzoj këto komunikime me e-mail me të paditurën, prandaj në kuptim të nenit 31 të LKA bëjë precizimin e kërkesëpadiës ashtu që i propozoj gjykatës që të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit dhe të anulojë aktvendimin e të paditurës dhe të obligojë të paditurën që paditësit t’ia kthej shumën prej 625.00 euro të paguar në emër të gjobës sipas aktvendimit kontestues. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se nga provat e administruara konsiderojmë se vërtetohet themelësia e kërkesëpadiës dhe në veçanti nga dokumenti i lëshuar nga Dogana e Italisë BTI 2019-0360M-138100 i datës 02.09.2019 me të cilën shteti eksportues ka konstatuar se kodi i saktë tarifor për këto mallra është kodi 84388010 e i cili dokument tashmë është vërtetuar si i saktë edhe në ekspertizën nga eksperti makinerisë N.Sh., i cili pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të mallrave në fjalë dhe të dokumentacionit në shkresa të lëndës ka konstatuar se kodi tarifor i saktë për këto mallra është kodi i lartcekur. Gjykatës i ka propozuar që të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit dhe të anulojë aktvendimin e të paditurës.

E paditura në përgjigje në padi të datës 11.01.2022 e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka shtuar se vendimi i atakuar është marr konform dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të

vetme duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pa bazuar dhe ta lë në fuqi vendimin konstuese si të ligjshëm. Gjatës seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 13.05.2024, ka deklaruar se sa i përket pretendimit të paditësit për pagesën e gjobës për aktvendimin 03.1.7-2019-927/2, posa kemi marrë informata nga paditësi kem dërguar në sektorin e financave, ku nga zyrtarët e financave kemi konfirmim se pagesa është bërë në shumë prej 625 euro. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se paditësi nuk ka arritur që të vërtetojë bazën juridike të kërkesëpadisë, sepse e paditura me aktvendimin kontestues 01.3.2.2/7275-19, 7114-19 të datës 07.05.2021 i ka refuzuar kërkesë paditësit dhe në arsyetimin e dhënë të aktvendimit me theks të veçantë është mendimi për klasifikimin tarifor nga sektori i tarifës. Sektori i tarifës është sektor në kuadër të Doganës së Kosovës dhe i specializuar për klasifikimin edhe tarifimin e mallrave ku në mendimin për klasifikim tarifor ka theksuar se kodi i deklaruar nga paditësi me numër 84388010 është jo i duhur dhe e ka klasifikuar mallin kontestues me numrin tarifor 8850940000, andaj nga kjo i propozojmë gjykatës të refuzojë padinë dhe kërkesë padinë si të pabazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal me aktgjykimin A.nr.1354/21 të datë 19.05.2022, kishte aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar aktvendimin kontestues të Doganës së Kosovës.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vendosur sipas ankesës së paditurës Dogana e Kosovës, me aktvendimin K.DH.SH.II.1466/22 të datës 11.07.2023, ka anuluar aktgjykimin A.nr.1908/19 dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 13.05.2024, ka administruar provat si në vijim: Procesverbalin e datës 19.05.2022(A.nr. 1354/2021), ekspertiza teknike e datës 14.03.2024, parashtrësë e paditësit për dorëzim të provave e datës 07.05.2024 dhe komunikimi me e-mail dorëzuar nga paditësi i datës 07 dhe 08 maj 2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjet në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, duke marr për bazë edhe vërejtjet e dhomave të shkallës së dytë të kësaj Gjykate, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishikimin e aktvendimeve me arsyetim se Sektori i Kontrollit Pas Importues ka vepruar drejtë ku ka obliguar subjektin që të paguaj obligimet doganore, pasi që deri tek konstatimi se subjekti duhet të paguaj obligimet doganore shtesë ka ardhur si rezultat i konstatimit të sjellë nga Sektori i Tarifës, bazuar në dokumentacionet përcjellëse të lëndëve, fotove, manualeve për produktet në kontest “mullinj elektrik për bluarjen e kafes-Fiorenzato” dhe “mullinj elektrik për bluarjen e kafes-Melis Giovani (Wega)” sektori i tarifës mendon se deklarimi i kodit tarifor 84388010 është jo i duhur, aparatet e sipër cekura janë aparatet për bluarjen e kafes të projektuara jo për qëllime shtëpiake dhe pavarësisht peshës të cekur në shënimin 4 të këtij kapitulli, si të tilla kodi tarifor i duhur është 8509 4000 00, dhe jo si makineri tjera të pa specifikuara të deklaruara gabim në kodin tarifor 84388010.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.575/23 të datës 05.02.2024 ka caktuar ekspertizë në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin e makinerisë N.Sh. me detyrat përkatëse sikurse në dispozitiv.

Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit i makinerisë në ekspertizën nga lëmia e makinerisë të datës 14.03.2024 dhe sqarimeve të paraqitura edhe në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 25.04.2024, për detyrat e caktuara për ekspertizë është dhënë mendimi dhe konstatimi se: *Makinat për bluarje të kafes të markës “FIORENZATO” Tipi F5, F6, F 63 K, F 71/ Itali/ me karakteristika teknike, mënyra e funksionimit, qëllimi i përdorimit është makinë për bluarje të kafes dhe bazuar në përshkrimet e cekura sipas (TARIK) Tarifa e Integruar e Kosovës,*

faqe 13 sipas mendimit tim bënë pjesë në kodin tarifor 8438 8010 00 ashtu sis është shënuar në Dokumentin Unik Doganor, nr.16485/01.06.2019 të përpiluar nga N.Sh.T., “Ronex” Suharekë.

Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare të datës 14.03.2024 të ekspertit N.Sh. nëtërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat.

Eksperti financiar në seancën e shqyrtimit gjyqësor – kryesor të datës 25.04.2024 ka deklaruar se: *ekspertizën teknike të dorëzuar me datë 14.03.2024 e kam përpiluar në bazë të dokumentacionit të cilin e kam pas në dispozicion dhe mendoj se detyrat e dhëna në aktvendimin e gjykatës i kam bërë në konstatimin i cili është bashkangjitur ekspertizës. Tutje ka shtuar se: në ekspertizë kam cekur se përpos dokumentacionit i cili është bashkangjitur e kam parë të arsyeshme të bëjë vizitë në kompaninë e cila merret me importimin e këtyre makinave. Arsyeja ka qenë sepse kam pas nevojë të bindem fizikisht se kemi të bëjmë me aparatet e cekura në lëndë, me që rast kam konstatuar dhe shënime tjera teknike të marruar nga makinat që janë dëshmuar me foto dokumentacion.*

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme ka bërë ndryshimin e kodit tarifor nga 8438 8010 00 në kodin tarifor 8509 40000 00, dhe e ka shpallur përgjegjës për kundërvajtje doganore nga neni 276 par .k) të Kodit doganor dhe Akcizave, subjektin në procedurë këtu paditësin N.T.P “Tafaj & CO” Sh.P.K., me seli në Gelancë, Komunë e Suharekës.

Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për klasifikimin e mallit lëndor, fakti se pavarësisht anës dokumentare se çfarë të dhëna përmban subjekti në procedurë duhet që mallin lëndor ta klasifikoj konform gjendjes faktike ashtu siç përshkruhet në TARIK, pra gjendja faktike të përputhet me të dhënat në TARIK, sepse me dispozitën ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK-së përcaktohet se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar*

dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjetitjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”.

Sipas nenit 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, është përcaktuar se dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”.*

Gjykata konstaton se në rastin konkret vërtetohet se paditësi me rastin e zhdoganimit të mallit me DUD-at R 19013, R 34794 dhe 16485, ka paraqitur kodin e saktë tarifor 8438 8010 00. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, konform nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Nisur nga kjo, gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b, të KDAK-së nr.03/L-109, nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, aprovoi kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t’ia pranoj deklarinimin e kodit tarifor 8528711500 për mallin lëndor sipas DUD-ave R 19013, R 34794 dhe 16485, dhe t’ia kthej shumën e paguar në emër të kundërvajtjes së pretenduar doganore në vlerë prej 625.00 Euro.

Gjykata i ka vlerësuar deklarinimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin lidhur me shpenzimet procedurale, gjykata e ka marr në pajtim me dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, gjykata konform nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.575/23, datë 13.05.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.